

URDHER

Nr. 38, Date 05.04.2005

PER

NGRITJEN E KOMITETIT NDERMINISTROR PER ZHVILLIMIN E TEKNOLOGJIVE TE INFORMACIONIT NE ADMINISTRATEN PUBLIKE

Ne mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, të nenit 11 të Ligjit Nr. 9000, datë 30.01.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Keshillit të Ministrave” dhe të Vendimit Nr. 216, datë 10.04.2003, të Keshillit të Ministrave, “Për miratimin e dokumentit të Strategjise Kombëtare të Teknologjive të Informacionit dhe Komunikimit”,

U R D H E R O J :

1. Ngritjen e Komitetit Nderministror për Zhvillimin e Teknologjive të Informacionit në Administratën Publike, si organ këshillimor pranë Keshillit të Ministrave

2. Ky Komitet të kryhesohet nga Ministri i Shtetit për Koordinimin dhe në përberje të këte:
 - Ministri i Financave
anetar;

 - Ministri i Drejtësisë
anetar;

- Ministri i Ekonomise anetar;
- Ministri i Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit anetar;
- Ministri i Transportit dhe Telekomunikacioneve anetar;
- Ministri i Rendit Publik anetar;
- Drejtori i Departamentit te Administrates Publike anetar;
- Drejtori i Agjensise se Prokurimit Publik anetar.

3. Ne mbledhjet e Komitetit Nderministror per Zhvillimin e Teknologjive te Informacionit, sipas çeshtjeve qe do te shqyrtojen, ftohet te marrin pjese edhe perfaqesuesi i Entit Rregullator te Telekomunikacioneve, perfaqesuesi i Institutit te Informatikes dhe Matematikes se Aplikuar, Kryetari i Shoqates se Bashkive, Dekani i Fakultetit te Shkencave te Natyres te Universitetit te Tiranës, si dhe perfaqesues te institucioneve te tjera publike e private e specialiste te fushes.

4. Komiteti Nderministror per Zhvillimin e Teknologjive ka keto detyra:

- bashkerendimin nderinstitucional te projekteve te informatizimit per veprimtarite te administrates publike;
- ndjekjen e hartimit dhe zbatimit te veprimtarise qeveritare per informatizimin e administrates publike;
- hartimin dhe ndjekjen e zbatimit te standarteve te njejta per projektet e informatizimit ne administraten publike;
- bashkerendimin e veprimtarise me institucionet donatore ne fushen e teknologjive te informacionit;

- miratimin paraprak te çdo projekti per informatizimin, te çdo investimi qe do te realizohet nga ministrive, institucionet e tjera ne varesi te Keshillit te Ministrave apo te ministrive si dhe te projektakteve per rregullat per informatizimin e administrates publike.
5. Drejtoria e Teknologjise se Informacionit dhe Departamenti i Administrates Publike, ne Kryeministri, te realizojne detyrat e sekretarise teknike te Komitetit dhe te hartoje materialet e mbledhjes.
 6. Ngarkohet Ministri i Shtetit per Koordinimin per ndjekjen e zbatimit te ketij urdheri.

Ky urdher hyn ne fuqi menjehere.

KRYEMINISTRI

FATOS NANO